

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Gjithsej 2 pikë:

Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka shkruar se çfarë kanë të përbashkët tekstet 1 dhe 2 (p.sh. **të përbashkët kanë titullin dhe autorin/të dy tekstet flasin për veprën "Revizori"/në të parin dhe të dytin tekst përmendet Gogoli dhe përgjigje të ngjashme që tregojnë për titullin dhe/ose autorin e "Revizorit"**).

dhe **1 pikë** nëse ka shkruar se çfarë kanë të ndryshme (p.sh. **ndryshimi është se i pari është një poster përkatësisht njoftim për shfaqjen teatrale, ndërsa i dyti është pjesë nga një kritikë (analizë letrare, teatrale)/teksti i parë tregon se ku dhe kur do të mbahet shfaqja, ndërsa i dyti përmbajtjen e veprës/shfaqjes dhe përgjigje të ngjashme që tregojnë ndryshimet që lidhen me shfaqjen ose veprën**).

DETYRA 2: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: **2. në gjysmën e parë të shekullit XIX**

DETYRA 3: Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të plotë të saktë: **S, P, P.**

DETYRA 4: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: **2. komedia**

DETYRA 5: Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjja tregon se **Revizori është veprë e gjinisë dramatike, përkatësisht se një nga veçoritë e kësaj gjinie është ndarja sipas personazheve/roleve ose se vepra/komedia është e destinuar për t'u vënë në skenë në teatër, si dhe përgjigje të tjera që bazohen në veçoritë e dramatikë në veprën letrare "Revizori" ose si në veprën letrare ashtu edhe në shfaqjen teatrale Revizori.**

DETYRA 6: Gjithsej 2 pikë:

Nxënësi duke u bazuar në fragment, ka plotësuar saktë tabelën.

Titulli i veprës	Emri dhe mbiemri i autorit	Gjinia letrare	Lloji letrar
Vdekja e një mbretëreshe	Rexhep Qosja	Dramatike	Monodramë

Nxënësi merr 1 pikë për 3 përgjigje të sakta.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

DETYRA 7: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: **2. mbretëresha.**

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

DETYRA 8: 1 pikë nëse nxënësi ka shkruar: *Monodrama zhvillohet në **çastet e fundit të jetës së mbretëreshës**, para vdekjes së saj, gjatë luftë etj.*

DETYRA 9: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar përgjigjen: *4. si barrë që sjell vetmi*

DETYRA 10: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar përgjigjen 2. Të shprehë mendimet e brendshme të personazhit

DETYRA 11: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Lexuesi mëson se në fund të jetës njeriu përballet me ndërgjegjen e vet dhe vlerëson gjërat e vërteta dhe përgjigje të tjera të ngjajshme.*

DETYRA 12: Gjithsej **3 pikë**

Nxënësi merr 3 pikë nëse ka shkruar: *Vargjet e dhëna janë lirike peizazhi/përshkruese. Emri Drilon tregon rrjedhën e kohës, vazhdimësinë e jetës dhe historinë e trazuar, si dhe lidhet me lindjen dhe vdekjen, etj. Në vargun e dytë është përdorur epiteti, kurse në nivel të poezisë personifikimi*
Nxënësi merr nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë.

DETYRA 13: Nxënësi merr **1 pikë** nëse sqaron se: Vargu tregon që koha vazhdon pa pushim, se jeta dhe ngjarjet historike nuk ndalen, dhe se Driloni është pjesë e kësaj rrjedhe të vazhdueshme, etj.

DETYRA 14: Gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr 2 pikë për plotësim të saktë të tabelës:

VARGJET	TITULLI	LLOJI LETRAR
Ka ra rrezja nder bajama! T' bin e vet kështu e pvetë e ama -Ç'ke, moj bi, qi kjan e fshan? Kjan e fshan, e vetullat vran?-	<i>Amë e bi</i>	<i>romancë</i>
Ky shpirt plot njerëzi që po largohet, Përpara kohe i thirur në atë jetë, Në qiell do zërë vend me të vërtetë, Ashtu siç e meriton, nëse do çmohet.	<i>Nga Kancioniera (libri i këngëve)</i>	<i>sonet</i>

Nxënësi merr nga 1 pikë për plotësim të saktë të një kompleti të titullit dhe llojit letrar ose për vargjet e para ose të dyta.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

DETYRA 15: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Klasa e fjalës – **emër**;
Gjinia – **mashkullore**;
Rasa – **kallëzore**.

DETYRA 16: Gjithsej **2 pikë**

Për shkrimin e foljeve të dhëna në kohën e kërkuar:

Gjyshi (mbështes – më se e kryer) **kishte mbështetur** dorën në supin e nipit.

Në jetën tuaj nuk (dëgjoj – e kryera) **keni dëgjuar** një gjë të tillë.

Nxënësi merr nga **1 pikë** për shkrimin e saktë të një foljeje të dhënë në kohën e duhur.

DETYRA 17: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: **shfletoj**;
zhvendos;
zhgardhoj;
shprish

DETYRA 18: Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: 2. Aplikimet dorëzohen në zyrën numër 12.

DETYRA 19: Gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë** për renditjen e saktë të fjalëve në rendin e duhur:

Apofoni: *marr-mora; dal-dola*

Metafoni: *plak-pleq; breg-brigje*

Nxënësi merr **1 pikë** për renditjen e saktë të fjalëve të rendit të parë ose të dytë.

VËREJTJE: Për shkak të gabimeve teknike pyetja do të vlerësohet me numër maksimal të pikëve për të gjithë nxënësit. Ju kërkohet ndjesë për këtë lëshim.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit *Brezi im dhe rrjetet sociale*.
Vërejtje: Hartimi lexohet edhe nëse është shkruar ose është filluar të shkruhet në vendin e parshikuar për planin e hartimit.

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përmend cilat janë rrjetet sociale të njohura që përdor brezi i tij dhe pse përdoren pikërisht ato rrjete.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt për çfarë qëllimesh brezi i tij përdor rrjetet sociale dhe sa kohë kalon në to.

Nëse shkruan më në detaje, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan sa kohë kalon në rrjetet sociale dhe 1 pikë nëse shkruan pse kalon aq shumë kohë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për afrimin ose largimin e njerëzve për shkak të përdorimit të rrjeteve sociale.

Nëse shpjegon më në detaje ndikimin e rrjeteve sociale në afrimin dhe/ose largimin e njerëzve, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për ndikimin e rrjeteve sociale në brezin e ti.
 Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit) 2 pikë Gjithsej 4 pikë <u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...) pjesërisht e saktë	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë → s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij 0 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike 1 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI SHKOLLOR 2025-2026

	<p>- 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--